

LINDJA E KRISHTIT 2005

Krishti u lind! Lavdërojeni!

Të Përndershëmëve dhe të Vyerve Klerikë, Monahë dhe Besimtarë të
Kishës Ortodokse në Amerikë

Të dashurit e mi në Zot,

“Të gjithë engjëjt në qiell janë të lumturuar dhe shumë po gëzohen sot! E gjithë
krijesa kërcen me gëzim sepse Shpëtimtar dhe Zot u lind në Betlehem!

Çdo gabim idolatrie u ndërpre dhe Krishti mbretëron përjetë!”

Litija e Krishtlindjes



P.O. Box 675
Syosset, NY 11791-0675
Tel: 516.922.0550
Fax: 516.922.0954
Website: www.oca.org

Duke festuar lindjen e Zotit, Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht, ne bashkojmë zërat tanë me ato të engjëjve duke lavdëruar Atë i Cili mori shëmbëlltyrën tonë njerzore në mënyrë që të na ripërtërijë ne dhe gjithë krijesën, që të mund të bëhemi “pjesëmarrës së natyrës së Tij divine, ashtu sikundër Shën Pjetri na kujton. Kjo është me të vërtetë një arsye për të qenë “të lumturuar” dhe “shumë të gëzuar!”

Tashmë bota në të cilën jetojmë shpeshherë dështon të kënaqet në këtë mrekulli, në këtë gëzim të patregueshëm. Shpeshherë, kuptimi i vërtetë i Krishtit dhe i lindjes së Tij është i rrethuar me polemika. Ka nga ata që kërkojnë ta reduktojnë rolin kryesor të këtij evenimenti në historinë e njerëzimit, si një gjë të zakonshme, si shumë “festa” të tjera, kështu që ai të kalohet në mënyrë private dhe të qetë pa u vënë re dhe të mos shpallet kurrë. Ndërkohë që “Krishti mbretëron përjetë”, idolatria, që mishërimi i Tij e fshiu, vazhdon të ekzistojë, duke provokuar ata që e shikojnë Atë si “Këshillues të Mrekullueshëm, Mbretin e Mbretërve dhe Zot të Zotërve, Atin e përjetshëm, Princin e Paqes”, duke i bërë ata më të zjarrtë kur shpallin që “Perëndia është me ne”, jo vetëm me fjalë, por më e rëndësishmja, nëpërmjet veprave dhe punëve të tyre.

Shërbesa e Krishtit nuk ishte aspak private. Ai predikoi në një turmë të gjerë njerëzish. Ai shëroi të sëmurët në prezencën e shumë njerëzve. Ai zbuloi plotësinë e së vërtetës tek të gjithë ata që e dëgjuan dhe pranuan ftesën e Tij për të “ardhur dhe shikuar”. Mesazhi i pendimit dhe faljes zbuluar në paravolitë dhe mrekullitë e Tij u vulos me vetë gjakun që Ai derdhi në vuajtjet dhe vdekjen e Tij publike. Ngjallja e Tij që u lajmërua tek mijëra vetë në Jeruzalem në ditën e madhe të Pendikostisë – (Rushajeve), dhe në të gjithë botën në ditët që pasuan, hapi dyert e një realiteti më të madh, atij të jetës së përherëshme në Mbretërinë e Tij.

Na vinë ndër mend fjalët e Profetit Isaia, “Ai erdhi tek të Tijtë, megjithatë të Tijtë nuk e njohën Atë”. Ungjilli që Krishti shpalli ishte, dhe akoma është, rrethuar me polemika, pikërisht sepse sfidon “gabimet e idolatrisë” që këmbëngul se kjo botë, dhe jo bota që do të vijë, ofron të gjitha gjërat e nevojshme, ç’do gjë që është reale, ç’do gjë që njeriu ka nevojë të arrijë “plotësimin” dhe “vetë-përmbushjen”. Krishti na thërret që të lemë mënjanë të gjitha përkujdesjet tokësore, duke filluar me dëshirën idolare për të parë vehten tonë, dhe jo Perëndinë, si qendrën e të gjitha gjërave, këto mbeten pengesa për të dalluar dëshirën e Tij, për të ndarë jetën e Tij dhe për të marrë pjesë në natyrën e Tij divine.

Në botën e sotme, të ngarkuar me luftëra, fatkeqësi natyrore, “shprehje korrekte shoqërore” dhe me një mungesë të përgjithëshme të dashurisë njerëzore, është e lehtë t’i dorëzohesh tundimeve dhe dyshimit. Është më lehtë të përqëndrohesh në përkujdesjet tokësore sesa në kënaqësitë qiellore. Mishërimi i Tij na fton të shikojmë mbrapa këtyre vështirësive, të njohim se megjithëse jetojmë në një botë në rënie, Mbretëria ngadhënjimtare e cila po vjen, është tashmë plotësisht e pranishme tek ne në Kishë, vetëm në qoftë se ne do t’i përgjigjeshim thirrjes së Krishtit: “Ejani... dhe Unë do t’ju jap juve qetësim”. Është në këtë dritë që të gjithë engjëjt e qiellit janë të lumturuar kur ata lajmërojnë njerëzimin se, liria nga egoizmi dhe izolimi nga Krijuesi i tij, u është dhuruar me dashuri të gjithë atyre që i largohen idolatrisë së kësaj jete dhe që lirisht shikojnë dhe pranojnë dhuratën e jetës së përjetëshme të zbuluar në plotësinë e shpellës së Betlehemit dhe, në të njëjtën kohë, në zbrazëtinë e varrit të Jeruzalemit.

Lutja ime është që këtë vit festimet e Lindjes së Zotit tonë, do të mbushen me gëzimin që vjen atëhere kur ne pendohemi me të vërtetë, kur përpiqemi me të vërtetë të lemë mënjane idhujt e kësaj bote dhe të kapërcejmë shqetësimet, kur ne jemi në gjendje të dallojmë që Krishti me të vërtetë “mbretëron përjetë”. Qoftë që ne, tani dhe në Vitin që po vjen, të shmangemi prej ngasjes se mund ti mbajmë barrat tona pa ndihmën e Tij. Le të riangazhojmë vehten tonë për të përqafuar praninë e Tij të përherëshme midis nesh me zellin dhe bindjen e ripërtërirë, duke u përpjekur për tu bërë “drita e botës” që Ai vetë na thërret të bëhemi.

Me dashuri në Zotin e Porsalindur,



+HERMAN

Kryepeshkop i Washingtonit dhe New Yorkut
Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë